NDREQJE GABIMI

Në vendimin e ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, "Mbi miratimin e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 127, datë 12.7.2016:

Në faqen e parë të licencës:

Ishte: *"Kodi Fiskal"*

Bëhet: *"NUIS".*

Po aty, paragrafi i fundit:

Ishte: *"Bazuar në autoritetin që i është dhënë në pjesën e pestë të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i jep këtë licencë prodhimi (Licenca), për të kryer aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (PEE), personit të lartpërmendur, i quajtur "I licencuari", subjekt i kushteve të kësaj licence, si dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej __, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE, në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu.",*

Bëhet: *"Bazuar në autoritetin që i është dhënë në pjesën e pestë të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i jep këtë licencë tregtimi (Licenca), për të kryer aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (PEE), personit të lartpërmendur, i quajtur "I licencuari", subjekt i kushteve të kësaj licence, si dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej ___, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE, në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu."*

Pika 3.6.4:

Ishte: *"I licencuari do ta njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve, për çdo ndryshim të:*

a) Adresës;

b) Statutit të të licencuarit;

c) Certifikatës së regjistrimit;

d) Kodit Fiskal;

e) Drejtuesve të lartë; ose",

Bëhet: *"I licencuari do ta njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve, për çdo ndryshim të:*

f) Adresës;

g) Statutit të të licencuarit;

h) Certifikatës së regjistrimit;

i) NUIS;

j) Drejtuesve të lartë; ose"